



Prishtinë, 14 dhjetor 2016

DRAFT UDHËZUES PËR LIBERALIZIMIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

1. Ky Udhëzues përcakton mënyrën, kushtet dhe kohën e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë, në nivelin e prodhimit dhe furnizimit të energjisë elektrike.
2. Përcaktimi i kushteve të referuara në paragrafin 1 të këtij Udhëzuesi do të shërbejë si mbështetje për amandamentimin dhe plotësimin e legjislacionit sekondar për të cilin ka mandat Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE).

Neni 2

Parakushtet për liberalizim të tregut

1. liberalizimi i tregut të energjisë do të bëhet në mënyrë graduale, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë ligjore për të përshtatur ndryshimin e ligjeve me gjendjen e sektorit të energjisë në Kosovë;
2. Parakushtet për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë janë:
 - 2.1. Njoftimi nga ana e ZRRE lidhur me trajtimin e gjenerimit të energjisë elektrike në harmoni me ligjet e reja;
 - 2.2. Amandamenti, plotësimi dhe përpilimi i të gjitha rregullave, parimeve dhe metodologjive në përputhje me ligjet në fuqi të sektorit të energjisë në Kosovë;
 - 2.3. Identifikimi i barrierave të cilat janë jashtë kontrollit të ZRRE-së dhe të ndërmarrjeve të licencuara në sektorin e energjisë.



Neni 3

Zhvillimi i konkurrencës

1. ZRRE, në konsultim me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe me Zyrën e Ndhmës Shtetërore, do të kryejë hetime lidhur me funksionimin e tregut të energjisë elektrike dhe raportin e Rregullatorit do t'a publikojë sa më shpejtë nga data e lëshimit të kësaj kornize.
2. Në rast se raporti konstaton se nuk kemi konkurrencë efektive të tregut të energjisë, ZRRE në bashkëpunim me akterët tjerë relevant, do të ketë mundësi që të vendosë Obligime të Shërbimit Publik, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve dhe sigurisë së furnizimit.

Neni 4

Gjenerimi i energjisë elektrike

1. Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, *“prodhuesit e energjisë elektrike janë të obliguar t’iu ofrojnë kapacitetin e tyre në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe të bazuar në treg të gjithë konsumatorëve në tregje me shumicë dhe pakicë duke përfshirë edhe atyre me obligime të shërbimit publik”;*
2. Korporata Energjetike e Kosovës (KEK SH.A.) do të dedikojë kapacitetin të tij prodhues në tregun e energjisë me shumicë nën kushtet e konkurrencës;
3. Rregullimi i çmimeve të gjenerimit do të ndërpritet më së largu më 31 mars të vitit 2017 dhe KEK do të ofrojë të gjithë energjinë e prodhuar me çmime të parregulluara;
4. KEK do t’i nënshtrohet kushteve të këtij neni, pas njoftimit nga ana e ZRRE;
5. ZRRE do të bëjë azhurnimin e amortizimit të akumuluar mbi bazën e rregulluar të aseteve të KEK, ku do të merret një vendim për mënyrën e kthimit tek konsumatorët për pjesën e amortizimit të pranuar nga KEK për investimet e parealizuar të periudhës rregullative 2013-2017;
 - 5.1. Kompensimi i konsumatorëve nga KEK do të realizohet brenda një periudhë dy vjeçare, ku KEK do të paguaj në mënyrë proporcionale për çdo MWh të energjisë së ofruar furnizuesve të brendshëm. Kalkulimet do të sigurohen nga ZRRE brenda një periudhe sa më të shkurtër.

Neni 5

Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme (BRE) dhe bashkëprodhimi

1. ZRRE do të amandamentojë dhe plotësoj legjislacionin sekondar që ndërlidhet me BRE deri më datë 31 mars të vitit 2017.
2. ZRRE do të sigurojë mekanizmin për shitjen e energjisë së prodhuar nga BRE nën kushte të rregulluara:
 - 2.1. Dispeçimi të bëhet me prioritet duke shfrytëzuar mekanizmin e certifikatave të origjinës;



- 2.2. Energjia e prodhuar nga BRE dhe e pranuar në Skemën Mbështetëse do të shitet me tarifa nxitëse të aprovuara nga Bordi i ZRRE;
3. Fondi për kompensimin e diferencës së çmimit të tregut dhe tarifave nxitëse do të krijohet në nivel të Transmetimit dhe të menaxhohet nga Operatori i Tregut:
 - 3.1. Vlera e fondit do të jetë e parashikuar për çdo vit vijues dhe do të alokohet në ngarkesat e transmetimit si €/MWh;
4. BRE do ti nënshtrohen kushteve të balancimit dhe kushteve tjera të përgjithshme sipas rregullave të lëshuara nga ZRRE.
5. ZRRE do të bëjë të gjitha përshtatjet në Rregullën për Vendosjen e Çmimit të Transmetimit për të mundësuar aplikimin e këtij neni.

Neni 6

Trajtimi i humbjeve të energjisë elektrike

1. Në përcaktimin e të hyrave dhe ngarkesave për Shpërndarje dhe Transmetim të energjisë elektrike, ZRRE lejon një nivel të arsyeshëm të humbjeve teknike dhe komerciale.
2. Humbjet e energjisë elektrike do të blihen nga Operatori i Sistemit dhe Transmetimit dhe Operatori i Shpërndarjes në tregun konkurrues të energjisë elektrike.
3. Humbjet në veri të Kosovës, do të inkorporohen në ngarkesat e Transmetimit, për një kohë derisa të hiqen barrierat politike.
4. ZRRE do të bëjë të gjitha përshtatjet në Rregullën për Vendosjen e Çmimit të Transmisionit për të mundësuar aplikimin e këtij neni.

Neni 7

Trajtimi i furnizimit me pakicë të energjisë elektrike

1. ZRRE ka krijuar kushte për nxitjen e furnizuesve të interesuar të futen në tregun e energjisë në Kosovë.
2. Bazuar në mundësitë dhe obligimet ligjore, ZRRE do të krijojë mekanizma për furnizim të kategorive të konsumatorëve fundor sipas definimit në ligjet e sektorit të energjisë duke përfshirë:

2.1. Furnizimin e garantuar (furnizuesi i mundësisë së fundit);

2.2. Shërbimin universal;

2.3. Derregullimin e çmimeve për kategori të konsumatorëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret për tu furnizuar me Shërbim Universal;

3. Brenda një periudhe gjashtë (6) mujore nga data e hyrjes në fuqi të ligjeve të reja, ZRRE do të përfundojë proceduar për krijimin e mekanizmit për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit:



- 3.1. Hartimi i metodologjisë për përcaktimin e çmimeve të cilat mund të faturohen nga furnizuesi i fundit për furnizimin e garantuar, ku çmimi do të jetë më i lartë në raport me çmimet e tregut me pakicë të energjisë elektrike, në mënyrë që konsumatorët të mos kenë nxitje për të qëndruar gjatë tek ky furnizues;
- 3.2. Përcaktimi i kriterëve tenderuese për përcaktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit;
- 3.3. Përfundimi i procedurave të tenderimit dhe në rast të dështimit të tij, ZRRE do të nominojë Furnizuesin e Mundësisë së Fundit.
4. Deri më datë 31 mars 2017, ZRRE do të krijojë mekanizma për furnizimin me shërbim universal:
 - 4.1 Hartimi i metodologjisë për përcaktimin e çmimeve të arsyeshme të Shërbimit Universal;
 - 4.2 Përpilimi i kriterëve të cilat duhet të plotësohen nga Furnizuesi për ofrimin e Shërbimit Universal;
 - 4.3 Zgjedhja e furnizuesit me Obligime të Shërbimit Publik (OSHP), i cili do të ofrojë Shërbimin Universal për konsumatorët të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara me Ligjin për Energji Elektrike (konsumatorët familjar dhe jofamiljar që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se dhjetë (10) milion euro, ose jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës).

Neni 8

Derregullimi i çmimit për konsumatorët fundorë

1. Derregullimi i çmimit të konsumatorëve fundorë do të bëhet në mënyrë graduale duke përdorur qasjen më të përshtatshme të mundshme me gjendjen aktuale.
 - 1.1. Konsumatorët industrial të kyçur në nivelin e Transmetimit 220kV, do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më datën e lëshimit të kësaj kornize;
 - 1.2. Konsumatorët industrial të kyçur në nivelin e Transmetimit 110kV, do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars të vitit 2017;
 - 1.3. Konsumatorët komercial në nivelet e tension 35kV, 10kV do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2018;
 - 1.4. Konsumatorët komercial në nivelet e tension 0.4kV do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike pas përpilimit të listës nga ana e ZRRE, e cila do të identifikoj konsumatorët të cilët nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj për furnizim me energji elektrike nga Shërbimi Universal.
 - 1.5. Të gjithë konsumatorët fundorë do të kenë të drejtën që të furnizohen me energji elektrike në tregun konkurrues nga momenti i aprovimit të këtij udhëzuesi.



Neni 9

Mbrojtja e konsumatorëve në nevojë

1. Ndonëse është përgjegjësi e Qeverisë, ZRRE do të bashkëpunojë në mënyrë aktive në krijimin e mekanizmit të mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë.
2. Për të shmangur ndër-subvencionimet në mes të kategorive të ndryshme të konsumatorëve, burimi i fondit për mbështetje të konsumatorëve në nevojë nuk duhet të jetë sektori i energjisë, por duhet të gjendet ndonjë formë tjetër e financimit.

Neni 10

Komunikimi me palët e treta

3. ZRRE do të sigurojë që i gjithë procesi i liberalizimit të tregut do të bëhet në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese.
4. Amandamenti, plotësimi dhe përpilimi i rregullave dhe parimeve do të bëhen në komunikim me publikun dhe të gjitha palët e interesit.
5. Komunikimi me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, do të bëhet mbi bazën e informimit dhe konsultimit në veçanti për:
 - 5.1. Përcaktimin e Obligimit të Shërbimit Publik për gjeneratorët duke përfshirë arsyen, kohëzgjatjen dhe ndikimin e këtyre masave në konkurrencën e tregut të energjisë (në rast se një obligim i tillë do të aplikohet për gjeneratorët);
 - 5.2. Përcaktimin e Obligimit të Shërbimit Publik për Furnizuesin me Shërbim Universal;
 - 5.3. Masat e marra rreth mbështetjes së konsumatorëve në nevojë; dhe
 - 5.4. Çfarëdo rregulle, parimi apo metodologjie të cilën Bordi e sheh të arsyeshme për konsultim.
6. ZRRE do të njoftojë paraprakisht konsumatorët të cilët do të kalojnë në kushtet e derregulluara të tregut brenda një kohe të arsyeshme.
7. Konsumatorët të cilët e gëzojnë të drejtën e Shërbimit Universal do të njoftohen me kohë mbi kushtet dhe të drejtat e Shërbimit Universal si dhe për implikimet në ndryshimin e faturës së energjisë.

Neni 10

Interpretimi

1. Në rast të ndonjë paqartësie, interpretimin e këtij Udhëzuesi duhet të bëjë Zyra e Rregullatorit për Energji.